



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË  
BASHKIA FUSHË-ARRËZ  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 224 prot.

Fushë-Arrëz, më 27. 01. 2025

PROCESVERBAL

I mbajtur sot, më 27.01.2025, ora 10:00, në Sallën e Mbledhjeve të Këshillit Bashkiak pranë Bashkisë Fushë-Arrëz.

Në mbledhje marrin pjesë:

- **Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak;
- **Lezina Ceca**, Zëvendëskryetar i Këshillit Bashkiak;
- **Bardhok Qafa**, Zëvendëskryetar i Këshillit Bashkiak;
- Këshilltarët: Afrim Ndoj; **Besjana Marku**; **Franc Doda** ;  
**Tereze Dema**; **Vjolca Tabakaj**; **Valentina Lleshaj**;  
**Zef Cara**; **Mustaf Pashkaj**; **Pavlin Qafa**.

( 12 këshilltarë nga 15 gjithsej)

Gjithashtu në mbledhje marrin pjesë:

- \* **Mikel Qafa**, Zëvendëskryetar i Bashkisë;
- \* **Pashk Prendi**, Drejtori i Shërbimeve Publike;

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak **specialistët e Bashkisë** që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore.

Gjithashtu prezent në mbledhje është edhe punonjësja e sekretariatit të Këshillit Bashkiak, Valbona Milla.

Mbledhja kryesohet dhë hapet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak, z.**Nikolin Bardhoku**:

Përvendetje të gjithëve! Mirë se keni ardhë në maledhjen e parë plenare të Këshillit Bashkiak për vitin 2025! Në vijim të njoftimit të fundit zhvillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak. Verifikojmë pjesëmarrjen e cila plotëson kushtet për zhvillimin e mbledhjes.

Parashtronhet rendi i ditës:

1. Miratimi i Projektvendimit për listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike 6 % për muajin Dhjetor 2024.

2. Miratimi i Kritereve për dhënien e Ndihmës Ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit.
3. Miratimi i Projektvendimit për Planin e Integritetit të Bashkisë Fushë-Arrëz për periudhën 2025-2027.
4. Miratimi i projektvendimit për listën emërore të përsituesve të subvencionimit me qira.
5. Miratimi i projektvendimit për shumën e bashkëfinancimit subvencionimit me qira.
6. Miratimi i projektvendimit për nivelin e qirave për struktura të ndryshme apartamenti.
7. Miratimi i projektvendimit për ngritjen e strukturës për menaxhimin e strehimit social në bashki.
8. Miratimi i projektvendimit për listat emërore të përsituesve për përmirësimin e banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara.
9. Rishqyrtimi i vendimeve të kthyera nga Prefektura.
10. Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, institucioneve, etj.
11. Të ndryshme.

**Sqarim:** Pika 7 e rendit të ditës për "Miratimi i projektvendimit për ngritjen e strukturës për menaxhimin e strehimit social në bashki" **përjashtohet** nga shqyrtimi në mbledhjen e sotme të Këshillit Bashkiak sepse mungon dokumentacioni i duhur.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Atëherë duke përjashtuar pikën 7 ju ftoj të miratojmë rendin e ditës përmes votimit:

➤ Miratohet rendi i ditës me shumicë votash:

<b>12 vota pro</b>	<b>0 vota kundër</b>	<b>0 vota abstenim</b>
--------------------	----------------------	------------------------

**Pika numër 1 e rendit të ditës:** Miratimi i projektvendimit për listën e përsituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike 6% për muajin Dhjetor 2024. Atëherë të referojë zyra dhe komisioni përkatës.

**Sidorela Katroshi**, Drejtoreshë e Emigracionit e Çeshtjeve Sociale, shpjegon se për muajin Dhjetor 2024 përsitojne ndihme ekonomike nga fondi i bllok-ndihmës i 6%, **33** familje, me fond **124,833** lekë nga fondi total i ndihmës ekonomike në vlerën **2,080,561** lekë dhe shpërndarë përsituesit e 6% në Shumën **122,450** lekë sipas Njësive Administrative.

**Franc Doda, Kryetar i Komisionit të Ekonomisë Financës Buxhetit**, jemi konsultuar me zyrën përkatëse në mbledhjen e Komisionit ku për këtë muaj nuk ka ndryshime. Personat që kanë dalë me pikë të pamjaftueshme nga skema e perfitimit të ndihmës ekonomike nuk i njohim asnjë në të gjithë Bashkinë, mbase janë të larguar me banim diku tjetër. Jemi dakord me listat e sjella.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak: Do t'ju luteshesha zyrës përkatëse, të gjunjë forma dhe të sensibilizojnë publikun lidhur me kriteret e përfitimit të 6% nga Ndihma Ekonomike. Le të pëfitojnë të gjithë ato persona apo familje që plotësojnë kriteret.

Duke qenë se ju komisioni keni rënë dakord i propozojmë Këshillit të miratojmë projektvendimin për listën e përsituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike 6 % për muajin Dhjetor 2024.

Atëherë ftoj këshilltarët të miratojmë projektvendimin për listën e përsituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike 6 % për muajin Dhjetor 2024 përmes votimit:

- Miratohet Projektvendimi për listën e përsituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike 6 % për muajin Dhjetor 2024 **me**:

**12 vota pro**

**0 vota kundër**

**0 vota abstenim**

**Pika numër 2 e rendit të ditës:** Miratimi i Kritereve për dhënien e Ndihmës Ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit.

**Franc Doda, Kryetar i Komisionit të Ekonomisë Financës Buxhetit**, jemi konsultuar me komisionin dhe kemi rënë dakord me kriteret ekzistuese për përfitimin e masës së ndihmës ekonomike prej 6% të listuara në Projektin që e kanë të gjithë në dosjet e tyre.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak: Liston kriteret paraqitura në projektpozim Theksoj që, Zyra e posaçme të ketë në vëmendje kriterin e fundit që familjeve një herë në tre muaj t'ju bëhet riaplikim në skemën e Ndihmës Ekonomike.

Atëherë, a ka ndokush për të shtuar diçka?

**Besjana Marku**, anëtare e Këshillit:

E kemi diskutuar disa herë që kush nuk banon fizikisht në Bashkinë Fushë-Arrëz të mos përfshihet në skemën e përfitimit.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak: Atëherë nëse ju jeni dakord shtojmë në listën e kritereve të paraqitura nga zyra ne Projektpozim edhe një kriter: Përsituesit nga kriteret e listuara në projekt, të masës së ndihmës ekonomike prej 6 % duhet të janë banues fizikisht në Bashkinë Fushë-Arrëz.

Atëherë ftoj këshilltarët të miratojmë listën e kritereve të paraqitura në Projekt duke shtuar një kriter: \* Përsituesit nga kriteret e listuara në projekt, të masës së ndihmës ekonomike prej 6 % duhet të janë banues fizikisht në Bashkinë Fushë-Arrëz.

- Miratohet Projektvendimi për Kriteret e dhënies së Ndihmës Ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit me një kriter të ri shtesë me:

**12 vota pro      0 vota kundër      0 vota abstenim**

**Pika numër 3 e rendit të ditës:** Miratimi i Projektvendimit për Planin e Integritetit të Bashkisë Fushë-Arrëz për periudhën 2025-2027.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak: Do të referojë në emër të Burimeve Njerëzore që kanë paraqitur planin e Integritetit, Aldi Lepuri, Jurist në Bashki.

**Aldi Lepuri**, Jurist në Bashki: Mësasi bën një përbledhje të draftit të Planit të Integritetit, material me të cilin këshilltarët janë njojur më parë thekson se Bashkia Fushë-Arrëz ka ndërmarrë nismën për miratimin e Planit të Integritetit për periudhën 2025-2027 me qëllim evidentimin dhe vlerësimin e risqeve të integritetit, si dhe hartimin e një plani masash për minimizimin e tyre në një plan afatmesëm. Ai fton këshilltarët të japid mendimet dhe sugjerimet e tyre lidhur me këtë Plan.

**Mikel Qafa**, zëvendëskryetar i bashkisë, thekson se me miratimin e Planit të Integritetit të gjithë punonjësit e Administratës së Bashkisë do të Përshkruajnë punën e tyre në mënyrë periodike me qëllim rritjen e performancës së punës dhe në shërbimet ndaj publikut. Kjo procedurë do të bëhet në internet.

**Afrim Ndoj**, anëtar këshilli: A e keni menduar mirë këtë që po thoni se do e bejmë?

**Mikel Qafa**, zëvendëskryetar i bashkisë: Unë them se kjo metodë llogaridhënie në njëfarë forme rrit dhe përmirëson cilësinë e punës së secilit e përrnjedhojë edhe performancën e tyre. Shtoj se mirë është të miratohet ky Plan.

Ftoj këshilltarët të miratojmë projektvendimin për Planin e Integritetit të Bashkisë Fushë-Arrëz për periudhën 2025-2027 siç është paraqitur në draftin e Planit.

- Miratohet Projektvendimi për Planin e Integritetit të Bashkisë Fushë-Arrëz për periudhën 2025-2027 me

**12 vota pro      0 vota kundër      0 vota abstenim**

**Pika numër 4 e rendit të ditës:** Miratimi i projektvendimit për listën emërore të përfituesve të subvencionimit me qira.

**Mikel Qafa**, zëvendëskryetar i bashkisë:

Bazuar në Ligjin nr.22/2018, "Për Strehimin Social", Ligjin 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, VKM :362 datë 29.05.2019, "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gjëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyren e llogaritjes se tij", VKM Nr.384, datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", VKM Nr.459 date 03.07.2019 "Për rregullat për administrimin e kërkësave të njësive të vetëqeverisjes vendore përfunduese nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë, mënyrën e

financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgieejse për strehimin", Grupi i Punës dhe zyra përkatëse kanë ndërtuar listën emërore të përfituesve të subvencionimit me qira. Këtë listë ju e keni të gjithë përpara.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Atëherë ftoj këshilltarët të miratojmë listën emërore të përfituesve të subvencionimit me qira përmes votimit:

- Miratohet Projektvendimi lista emërore e përfituesve të subvencionimit me qira **me:**

**12 vota pro      0 vota kundër      0 vota abstenim**

**Pika numër 5 e rendit të ditës:** Miratimi i projektvendimit për shumën e bashkëfinancimit subvencionimit me qira.

**Mikel Qafa**, zëvendëskryetar i bashkisë: Siç u tha më parë bazuar në të njëjtën legjislaturë Grupi i punës dhe financa kanë përllogaritur shumën e bashkëfinancimit subvencionimit me qira të cilën e keni të pasqyruar në projektvendimin që keni para. Nëse jeni dakord unë ju propozoj t'a miratoni këtë projekt.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Atëherë ftoj këshilltarët të miratojmë projektvendimin për shumën e bashkëfinancimit subvencionimit me qira.

- Miratohet Projektvendimi për shumën e bashkëfinancimit subvencionimit me qira **me:**

**12 vota pro      0 vota kundër      0 vota abstenim**

**Pika numër 6 e rendit të ditës:** Miratimi i projektvendimit për nivelin e qirave për struktura të ndryshme apartamenti.

**Mikel Qafa**, zëvendëskryetar i bashkisë:

Ky Projektvendim është hartuar në mbështetje të ligjit Nr. 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", nen 24; Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale", pika 3 ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. Në relacionin që shoqëron Projektvendimin keni të pasqyruar nivelet e qirave për struktura të ndryshme të apartamenteve të banimit.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak: Meqë ky projektvendim ka kaluar kamisionin e përkatës edhe unë ju propozoj që t'a miratojmë përmes votës.

- Miratohet Projektvendimi për nivelin e qirave për struktura të ndryshme apartamenti **me:**

**12 vota pro      0 vota kundër      0 vota abstenim**

**Pika numër 7 e rendit të ditës:**

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak: Në fillim të mbledhjes proceduam me miratimin e rendit të ditës pa pikën 7, ku cituam se nuk do të trajtohet në këtë mbledhje, për arsy se mungon dokumentacioni i duhur.

**Pika numër 8 e rendit të ditës:** Miratimi i projektvendimit për listat emërore të përfituesve për përmirësimin e banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara.

**Mikel Qafa**, zëvendëskryetar i bashkisë:

Në projektvendimin për listat emërore të përfituesve për përmirësimin e banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara keni bazën ligjore ku jemi bazuar për ndërtimin e kësaj liste.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Atëherë ftoj këshilltarët të miratojmë projektvendimin për listat emërore të përfituesve për përmirësimin e banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara

- Miratohet Projektvendimi për listat emërore të përfituesve për përmirësimin e banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara **me**:

**12 vota pro**

**0 vota kundër**

**0 vota abstenim**

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

**Pikat numër 9; 10; 11 të rendit të ditës nuk kanë asnjë dokument për të shqyrtuar.**

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Meqë nuk kemi diçka tjeter për të shqyrtuar mbledhjen e deklaroj të myllur këtu.

Duke ju falenderuar për pjesëmarrjen ju uroj suksese dhe mirë u takofshim në mbledhjen e radhës!

**SEKRETAR**

Naze SELIMAJ



**KRYETAR**

Nikolin BARDHOKU

Franc Doda

Bavilluk Dafa

Faqe 6 në 6